



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:258355
Datë: 01.12.2021
Numri i dokumentit: 02456077

ARJ nr.104/2021

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Muhamet Rexha anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, NTP “M.”, me pronar E.F. F., me seli, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve, ”Avokatura Istrefi”, me seli në P....., me bazë juridike anulim i vendimit të paditurës nr....., të dt. 19.05.2017, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, parashtruar nga e paditura, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. nr. 486/2021 të datës 27.07. 2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 18 nëntor 2021, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hudhet si e palejuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e të paditurës Komuna Prishtinë, parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA. nr. 486/2021 të datës 27.07. 2021.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AA nr. 486/2021 të datës 27.07. 2021, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Prishtinës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.215/2018 i datës 01.04.2021, vërtetohet, e me të cilin në pikën I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTP “M.” me pronar E.F. F. me seli në P..., në pikën II. Anullohet aktvendimi nr., i datës 19.05.2017, i Bordit të Ankesave-Komuna e Prishtinës, dhe lënda

kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje dhe në pikën, III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të lartë cekur të Gjykatës së Apelit, e paditura Komuna e Prishtinës për mes përfaqësueses sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “Avokatura Istrefi”, në afat ligjor në Gjykatë Supreme, parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative. Propozon që kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të pranohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr. 486/2021 i datës 27.07.2021, të ndryshohet ashtu që padia e paditësit të refuzohet si e pa bazë, ndërsa vendimi i të paditurës nr., i datës 19.05.2017, i Bordit të Ankesave-Komuna Prishtinë, të vërtetohet se është nxjerrë konform dispozitave ligjore dhe i njëjti të lihet në fuqi, apo lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme pasi i shqyrtoi pretendimet e të paditurës në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, vlerësimi të aktgjykimit të kontestuar si dhe shkresave tjera të lëndës, në kuptim të nenit 52.1, të Ligjit për konfliktet administrative, gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e palejueshme.

Me nenin 24 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet që kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrorë në Gjykatë Supreme, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrorë vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishin ndikim në zgjidhjen e çështjes. Me nenin 50 të Ligjit për Konfliktet Administrative, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i parashtrorë gjykatës brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë nga data e pranimit të vendimit kundër të cilit paraqitet kërkesa.

Duke pasur parasysh dispozitat e lartë cekura të Ligjit për Konfliktet Administrative, kjo gjykatë gjen se pala mundet të parashtrorë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, vetëm kundër vendimit të plotfuqishëm të gjykatës së shkallës së dytë për çështje administrative. Pasi që me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr. 486/2021, të dt. 27.07.2021, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për çështje administrative, A.nr.215/2018 i datës 01.04.2021, me të cilin aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTP “M.” me pronar E.F. F., me seli në P....., ndërsa anulohet aktvendimi i të paditurës me nr., i datës 19.05.2017, i Bordit të Ankesave-Komuna e Prishtinës, dhe lënda i është kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje. Me këtë mënyrë të vendosjes nga gjykatat nuk bëhet fjalë për vendim të plotfuqishëm gjyqësor, sepse lënda është kthyer në rivendosje, prandaj kjo gjykatë e hedhë poshtë si të palejuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

Numri i lëndës: 2019:258355

Datë: 01.12.2021

Numri i dokumentit: 02456077

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 52 paragraf 1, lidhur me nenin 24 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
ARJ nr.104/2021, me datë 18 nëntor 2021

Procesmbajtës,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani